



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura IV  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 119/13  
Prishtinë, më 19.07.2013, ora 09:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Naser Osmani, Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku dhe Arbreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Agim Krasniqi-Drejtor i Buxhetit, Teki Shala- Ekspert i Jashtëm.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura e Komisionit, dt. 12.07.2013;**
3. **Miratim i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-174 për Palanifikim Hapësinor me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
6. **Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja** konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit 12.07.2013;**

**Hykmete Bajrami** vlerësoj se gjatë përpilimit të procesit stafi duhet të ketë kujdes me gramatikën që ajo çka shkruhet të ketë kuptim sepse nuk e besoj që ajo që flasim është e pakuptimtë.

**Kryetarja** theksoi se procesverbali miratohet me vërejtjen e deputetes Bajrami.

## **3. Miratim i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;**

**Latif Gashi** konsideroj se i kemi votuar amendamentet me përjashtim të dy ndryshimeve që mendojmë ti bëjmë.

**Kryetarja** njoftoj anëtarët e Komisionit që ka ardhur një kërkesë nga Drejtori i Agjencionit për menaxhimin e komplekseve memoriale dhe është në amendamentin 25. Gjatë ditës së djeshme kemi bërë përpjekje që të ndahet si vijë buxhetore, me përkrahjen e drejtorit të buxhetit kemi kërkuar të krijojmë një kod të ri meqenëse institucioni është themeluar. Për shkak të kohës së shkurtër dhe pamundësisë të analizojmë gjithçka në lidhje me këtë agjencion. Gjatë shqyrtimit të ligjit për komplekset memoriale si Komision kemi dhënë Raportin negativ që të mos miratohet ligji për shkak të implikimeve buxhetore. Kemi kontaktuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ashtu siç kanë premtuar se tre punëtorë do ti bartin nga Ministria dhe është konfirmuar se tre punëtorët kalojnë në Agjencionin për menaxhimin e komplekseve memoriale dhe duhet të bëhet përcaktimi i pagës së Drejtorit ekzekutiv i këtij agjencioni.

Amendamenti 1,2,3,4,5,6,7 miratohet pa ndryshime.

**Kryetarja** njoftoi se amendamenti 8 është si rezultat i ndryshimeve që janë bërë pastaj është harmonizuar.

**Albana Fetoshi** pyet se a nënkupton kjo se ka rritje në *Mallra dhe Shërbime* tek zyra e kryeministrit ? Shihet se ka rritje në *Paga dhe Mëditje* por nëse shohim rishikimin buxhetit rritja është edhe aty për *Mallra dhe Shërbime*. Pse është kjo rritje kaq e madhe?

**Agim Krasniqi** sqaroi se në materialin që është pranuar sot janë tre ndryshime të cilat kanë ndodhur nga momenti që i kemi sjell tabelat në Komision janë tre vendime urgjente të Qeverisë, është ZKM 350,000€ rritje *Mallra dhe Shërbime* për arsye se kjo zyrë i paguan shpenzimet e të gjitha delegacioneve që shkojnë në Bruksel. Ministria e Punëve të Jashtme për shkak se është caktuar nga Kuvendi një konsulatë e jashtme dhe vendimi për ndarjen e mjeteve për shoqatat e dala nga lufta (blerja e protezave, ndërrimi i tyre).

**Albana Fetoshi** kur është fjala për Ministrinë e Punëve të Jashtme nuk mendoj se është e arsyeshme për shkak se në rishikim e buxhetit nuk është se ka pasur shumë rritje në *Mallra dhe Shërbime* por nëse e shohim Zyrën e Kryeministrit shohim se ka pasur rritje.

**Agim Krasniqi** sqaroi se nuk është për zyrën e Kryeministrit por është për të gjitha delegacionet.

**Besim Beqaj** këto dy vendimet në nivel të Qeverisë, të cilat janë njëra për rritje të *Mallrave dhe Shërbimeve* si rezultat i vizitave të delegacioneve të cilat kanë qenë shpenzime të mëdha, ne e kemi rrit atë me vendim të Qeverisë dhe ka shkuar nga Rezerva buxhetore. Meqenëse MPMS nuk e ka futur pagesën për rehabilitim dhe për proteza të cilat do të duhet të ishin pjesë e tregut buxhetor ne e kemi bërë

një ndarje nga rezerva buxhetore për të tejkaluar këtë. Sa i përket Ministrisë është çështja e ngritjes së kapaciteteve të tyre për marrëdhëniet me jashtë, pra nuk kemi asnjë lloj shqetësimi në kontekstin e ndarjes buxhetore.

Me shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Sevdije Lama, Xhevdet Neziri) dhe dy vota Kundër (Albana Fetoshi dhe Hykmete Bajrami) dhe asnjë Abstenim miratohet amendamenti 8.

**Besim Beqaj** theksoj se është analizuar edhe një herë gjendja e INFRAKOS-it janë dy mundësi me të cilat çështja mund të zgjidhet, njëra është që ti rekomandoj Ministrin të Infrastrukturës që ta rishikoj mendimin për tarifat dhe do ta bëjmë këtë, meqenëse situata është emergjente dhe është vërtet serioze kemi konsultuar edhe Ministrin e Zhvillimi Ekonomik propozoj që të bëhet një ndarje dhe ndërkohë të merret Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Zhvillimit, ti harmonizojnë qëndrimet e të dy ndërmarrjeve publike. Paratë duhet të merren nga rezervat buxhetore, është e vetmja rrugë që duhet të bëhet.

**Hykmete Bajrami** pyet se a ka mundësi të dijmë se ndryshimet tjera cilave amendamente iu referohen psh shoqatat për proteza?

Me gjashtë vota Për ( Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Xhevdet Neziri) dy vota Kundër (Hykmete Bajrami dhe Sali Asllanaj) dhe një Abstenim (Albana Fetoshi) miratohet amendamenti për ndarjen e mjeteve në shumë prej 150,000 € në emër të Infrakos-it.

Amendamenti 10 dhe 11 miratohen njëzëri.

**Hykmetja Bajrami** theksoj se nuk është përfshirë 100.000 kurse për shoqatat për të verbër a duhet me hy aty në Ministri.

**Agim Krasniqi;** në Ministri nuk është për arsye se këto mjete janë nda prej rezervës dhe janë transferuar përmes Ministrisë së Financave apo thesari se duhet me u transeferu prej OJQ ve, nuk mundet me u transferu Ministria e Financave në thesar tani janë transferuar në llogari të këtyre shoqatave.

Amendamenti 12, 13 dhe 14 miratohen njëzëri.

**Kryetarja** Amendamenti 16 këtu kemi ndryshime, nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, 3 punëtor kalojnë në Agjensionin për Menagjimin Komplekseve Memoriale , edhe kjo është te MMPH nën programi 602 nga 14 në 11 , kanë shkuar 10.000 euro si sgjensia memoriale te pagat e mëditjet ndryshon prej 600.000 zvogëlohet shuma në 603.000 në Agjensionin për Memorialet ndryshohet shuma në kapitale prej 3.525.000 në 2.779.000 për projektin memorial Adem Jashari në Prekaz i cili bartet në Agjencinë e Komplekseve Memorjale . Dje jemi informu se memorjalet tjera janë në procedurë dhe nuk ka mundesi me kalu në menagjimin e komplekseve memoriale.

Amendamenti 16, 19, 20 dhe 24 miratohen njëzëri.

**Agim Krasniqi** avokati i popullit ju e dini se edhe Kuvendi e të gjithë jemi ballafaqu e komisioni Evropian e kan pru urgjent nuk e ka prit me u kry rishikimi por e kanë sjell një kërkesë me ndryshu në mes kategorisë Mallra e kapitale mbrenda institucionit me i ble dy vetura, është transfer i brendshëm tek avokati i popullit. Agjencia për Komplekse Memoriale që duhet të formohet si agjencion i ri që duhet ti I raportoj Kuvendit poashtu shtohet numri i punëtorëve. Në ligjin që është miratuar thotë se drejtori duhet

ta ketë pagën në harmoni me drejtorat e agjensioneve tjera të cilat janë themeluar, ne e kemi marrë mesatarën e këtyre agjensioneve sa më të vogla dhe paga le të caktohet 1200 euro.

**Sali Asllanaj** kryetarët e komunave e udhëheqin një komunë që i kanë 100.000 apo 500.000 banorë dhe i marrin 1200 euro pagat por unë jam kundër këtij agjencioni.

**Kryetarja** thekson se sipas ligjit që u miratu në komision kemi qenë kundër por duhet të respektohet ligji që është votu në Kuvend.

**Hykmete Bajrami** thekson se prej agjensioneve nuk e kemi marrë mesataren në faktë kemi shku me paga maksimale por kemi edhe agjencione të pavarura me pagë më të ulët, kur e shohim shpenzimet kapitale të një agjencioni janë 745 për kompleksin Adem Jashari, ky person ka me hap një tender dhe përgjegjësia e këtij personi ta ketë pagën 1200 euro. Unë nuk pajtohem me këtë pasi e di se pagë të ulët ka Komisioni i Pavarur për Media.

**Kryetarja** thekson se Komisioni për Media merrë kompenzim dhe e ka pagën 800 euro e agjensionet tjera i kanë 1200 euro.

**Latif Gashi** Kuvendi e ka zgjedh me vota unanime pastaj kanë nxjerr ligj, po ky komision dhe komisionet tjera paraprake i kanë caktuar ato paga, 34 përfaqësuesve të pavarur të cilat i kanë pagat shumë të larta dhe mua nuk më duket shumë për një drejtor të agjencionit, e kisha hedh te kryetarët e komunave këtë menagjim të komplekseve. Sa i përket punëve a do të ketë punë ky komision, unë mendoj se po sepse të gjitha komplekset memoriale do të kalojnë në menagjimin e tyre dhe do të ketë shumë punë se në Kosovë ka komplekse memoriale mirëpo më së miri ka qenë me i menagju kuvendet komunale.

**Besim Beqaj** theksoj se do të ishte mirënjohës se në takimin e radhës të bëjmë një diskutim ne dhe komisionin së bashku për çështjen e pagesës së Agjensioneve të pavarura. Ne do të duhej hapin e radhës të bëjmë një unifikim të pagave këtyre agjensioneve sepse ky është agjencion i themeluar nga Kuvendi.

**Kryetarja** ne nuk mund të marrim asnjë vendim lus Ministrinë e Financave të bashkëpunojnë me Ministrinë e Administratës Publike dhe të na sjellin ligjin në Kuvend. Pa ligj nuk mund ti harmonizojmë pagat e institucioneve të pavarura, nuk mund ta bëjë komisioni këtë punë të mundimshme dhe pa bazë ligjore.

**Besim Beqaj** ne nuk po kërkojmë asnjë gjë që nuk ka bazë ligjore. Ne jemi duke marrë një vendim për një pagë, dhe atë që po propozojmë është që në vitin e ardhshëm, nëse ligji nuk vjen ne mund ta sjellim një vendim uniformë për nivelizimin e pagave të drejtorëve të agjensioneve të pavarura.

**Hykmete Bajrami** prej fillimit të legjislaturës ne kemi problem me këto paga sepse kemi diversifikim në nivele të ndryshme. Kemi marrë disa herë listën e pagave për ti unifikuar, ka ardhë ligji në Kuvendi ia ka kthyer Ministrisë, justifikimi është që ne po presim ligjin. Ligji nuk po vjen sepse si duket lobimi për mos me ardh ligji është shumë më i madh se sa vullneti për me prur ligjin. Pra nuk ka vullnet politik që të bëhet rregullimi i pagave të funksionarëve të lartë. Siç po e shohim çdo ditë na formohen agjensione, unë kam një bindje që kjo po bëhet që të krijohen vende të punës për miqtë dhe dashamirët.

**Albana Fetoshi** sa i përket ligjit të pagave të funksionarëve të lartë që sa kohë ka që po flitet ky problem, si ne nuk e kemi ligjin për pagat e funksionarëve të lartë dhe po na vinë kështu agjencione të ndryshme dhe po duhet me i rregullu Kuvendi. Mendoj që Ministria përkatëse është dashur ta sjellë ligjin,

sepse vetëm të arsyetohemi duke thënë që ne nuk kemi ligj këtë tashmë po e dimë. Çështja tjetër ka të bëjë me shumatat, por pikërisht mungesa e ligjit po na sjellë në një situatë të tillë, ku shumatat vijnë kështu paushalle dhe nuk ka ligj që e rregullon këtë çështje. Kështu që unë jam që pagat e drejtorëve të agjencioneve të larta të janp më të ulëta por edhe e deputetëve, dhe kjo çështje të jetë e rregulluar me ligj. Kur e kemi parasysh se me çfarë paga të ulëta jetojnë një pjesë e madhe e qytetarëve të vendit, do të duhet që të ketë një barazi më të madhe në ndarjen e pagave.

**Xhevdet Neziraj** parimisht kam qenë kundër këtyre agjencioneve dhe jam ende, është mirë që vitin e ardhshëm ta kemi ligjin, po nëse nuk e kemi ligjin ta bëjmë ne unifikimin e pagave që mos të ketë laramani.

**Latif Gashi** parimisht të gjithë anëtarët jemi kundër me pas paga jo të harmonizuara, mirëpo duke marrë parasysh që kemi një vendim të Kuvendit dhe një ligj që u miratu për themelimin e këtij agjencionit, propozoj që paga bruto ti bëhet 1,100 euro.

Amendamenti 25 miratohet me 1 votë kundër Hykmete Bajrami dhe 1 abstenim Albana Fetoshi .  
Amendamenti 26 -34 miratohen njëzëri.

**Sevdije Lama** me qenë se është bërë ky ndryshim për INFRAKOSIN propozojë me nda një shumë si subvencion për ngrohtoren e Gjakovës. Nuk është e drejtë që në komunat tjera të ndahen mjete ndërsa në komunën e Gjakovës të mos shkojë asnjë cent.

**Besim Beqaj** tek komuna e Gjakovës kemi pas një kërkesë prej 2 milion euro dhe ka qenë e paspecifikuar dhe nuk mund të bëjmë ndarje. Ngrohtoret vetëm në këtë vit i kanë të parapara 3 milion euro subvencione dhe ato u janë ndarë, problemi është se ato i kanë shfrytëzuar para kohës subvencionet e tyre, duke supozuar se gjatë verës do i inkasojnë mjetet, pra ky është një problem i menaxhimit.

Amendamenti 35 dhe 36 miratohen njëzëri.

Komision pas shqyrtimit dhe votimit të amendamenteve të propozuara , me 4 vota kundër (Sevdije Lama, Xhevdet Neziraj, Sali Asllanaj dhe Hykmete Bajrami) dhe 5 vota Për, asnjë Abstenim, nxorri këtë

### **Rekomandim**

Miratohet raporti me amendamente (me ndryshimet që u bënë në mbledhjen e Komisionit) për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe i njëjti procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë me amendamentet e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Komisioni njëzëri nxorri këtë

### **Rekomandim**

Projektligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë me amendamentet e Komisionit Funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media nuk përmban implikime shtesë.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor me amendamente të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Komisioni njëzëri nxorri këtë

**Rekomandim**

Projektligji për Planifikim Hapësinor me amendamente të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor nuk përmban implikime shtesë.

**6. Të ndryshme**

**Kryetarja** njoftoj se të hënën do të jenë të gjitha pikat e mbetura të Komisionit në mënyrë që të përfundojnë.

**Hykmete Bajrami** propozoj që pjesa që ka mbetur në kuadër të aktiviteteve për monitorimin e ligjit për prokurimit publik të shtyhet për Shtator.

Anëtarët e komisionit, u pajtuan që grupi punues për mbikëqyerjen e zbatimit të ligjit për prokurimit publik në republikën e Kosovës, të vazhdojë në shtator.

Mbledhja përfundoi: 13:30

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Safete Hadergjona**